

C.nr.919/16

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Enes Mehmeti, me bashkepuntoren profesionale Kreshnike Zymberi, në çështjen juridike-civile të paditëses [REDACTED] nga [REDACTED] rr.” [REDACTED] p.n., kundër të paditurës Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Ferizaj të cilën e përfaqëson me autorizim Agim Rexhaj nga Ferizaj, për pagesën e diferencës së pagës, në seancën kryesore publike të mbajtur më 23.08.2017, në prezencën e paditëses dhe përfaqësueses së të paditurës, merr:

### **A K T G J Y K I M**

**I- APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesë padia e paditëses [REDACTED] nga [REDACTED] rr.” [REDACTED] p.n., e ushtruar kundër të paditurës Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Ferizaj dhe **DETYROHET** e paditura që të i’a njoh paditëses koeficientin 10.2 të pagës për pozitën Shef për Buxhet dhe Financa pranë QKMF-së në Ferizaj dhe atë nga data 01.03.2016.

**II- OBLIGOHET** e paditura Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Ferizaj që paditëses në emër të fitimit të munguar për periudhën 01.03.2016 deri me datën 28.02.2017 të i’a paguaj shumën prej 3,505.70€ (tremijë e pesëqind e pesë euro e shtatëdhjetë cent) në emër të diferencës së pagës si dhe të paguaj në emër të paditëses shumën prej 205.01€ në Trustin Pensional të Kosovës dhe shumën prej 389.52€ në Administratën Tatimore të Kosovës në emër të tatimit për të ardhura personal, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

**III- OBLIGOHET** paditësja që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj taksën gjyqësore në shumë prej 40€ pas pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kercenimin e pasojave ligjore.

### **A r s y e t i m i**

Paditësja në këtë Gjykatë me datën 28.12.2017, ka ushtruar padinë kundër të paditurës, në çështjen për pagesën e diferencës së pagës sipas koeficientit të përcaktuar me kontratë si dhe ka bërë rregullimin e kërkesëpadisë në seancën e datën 23.08.2017.



Nga provat e administruara Gjykata ka konstatuar këtë gjendje faktike, bazuar në kontratën e punës të datës 01.03.2016, është vërtetuar fakti se paditësi [REDACTED] me të paditurën QKMF në Ferizaj kanë themeluar mardhënjën e punës nga data 01.03.2016 në bazë të nenit 2 të kësaj kontrate shprehimisht parashihet se i punësuari do ti kryej detyrat e punës si për pozitën Shefe e Shërbimit për Buxhet dhe Financiar në QKMF në Ferizaj.

Në bazë të nenin 7 të kësaj kontrate është përcaktuar se punëmarrësit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin, në lartësi prej 771€ së paku një herë në muaj e cila nuk mund të jetë më ulët se paga minimale.

E paditura nga data 01.03.2016 deri me datën 28.02.2017 paditëses asnjëhere nuk i ka paguar pagën në lartësin e kontratuar me Kontratën e Punës të datës 01.03.2017, por në të njëjtën ka vazhduar ta paguaj me koeficientin e pagës 7 nga pozita e punës së më hershme, nga kjo del se pretendimet e paditëses lidhur me kompensimin e diferencës së pagës janë të bazuara.

Gjykata po ashtu ka marr si provet Kontraten e Punës të lidhur ndërmjetë të paditurës QKMF-së dhe [REDACTED] i cili ka ushtruar detyrat e punës në pozitën e punës Sher i Shërbimit për Buxhet dhe Financa, i cili sipas kontratës së datës 21.05.2010 në pozitën dhe detyrat e punës të cilat i ushtron tani paditësja [REDACTED] ka pasur koeficientin e pagës 10.2, koeficient ky me të cilin i njëjti ka marr pagën mujore, e për të cilën duhet të paguhet në të njëjtën page tani edhe paditësja.

Paditësja me datën 18.11.2016 i është drejtuar të njëjtës (punëdhënësit) QKMF-së me një shkresë ku ka kërkuar nga e njëjtat që ti kompensohet diferenca e pagës sipas koeficientit të përcaktuar me kontratën, mirëpo e njëjta nga e paditura nuk ka marr përgjigje lidhur me këtë çështje, andaj paditësja pasi që në afat prej 15 ditësh duke u llogaritur nga data 18.11.2016, nuk ka pranuar përgjigje nga e paditura, me datën 28.12.2016 ka parashtruar padinë për kompensimin e të ardhurave në bazë të Kontratës së Punës të datës 01.03.2016, padi është ushtruar në afatin ligjor të përcaktuar në bazë të nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës (ligji nr.03/L-212).

kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me kontratën e punës”, e që është e përcaktuar me nenin 7 të kontratës së punës të lidhur në mes të paditurës dhe paditësit.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e mbështeti në nen.452.1 të LPK-së dhe e obligoi të paditurën që paditësit, ti paguaj shpenzimet e procedurës, për taksat gjyqësore shumë prej 40€, shuma e taksës është përcaktuar në bazë të nenit 1, 8 pika 8.1.1 dhe 12 pika 12.1, të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017, për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Gjykata në bazë të lartëcekurave ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

C.nr.919/16, me datën 23.08.2017

Gjyqtari,  
Dnes Mehmeti



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JË PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROSEVAC

20 17

